

ANKESË

DREJTUAR: **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), Prishtinë**

NGA: Grupi i Operatorëve Ekonomik **MEB L.L.C. & KSF MAJOR SH.A**

KUNDËR: Autoritetit Kontraktues **Komuna e Drenasit (Departamenti i Prokurimit)**

NUMRI I AKTIVITETIT TË PROKURIMIT: **611-26-2698-2-1-1,**

TITULLI I KONTRATËS: **SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE TË ADMINISTRATES SE PERGJITHSHME, OBJEKTIT TE ARKIVIT KOMUNAL NE DRENAS OBJEKT I VECANT, SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE – GJIMNAZIT SKENDERBEU DHE SHMP TE TEKNIKES FEHMI LLADROVCI,**

Data: 30.07.2026



Mbi bazën e nenit 105, nenit 108/A dhe nenit 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, Grupi i Operatorëve Ekonomikë MEB L.L.C. & KSF MAJOR SH.A., në cilësinë e operatorit ekonomik pjesëmarrës dhe palës me interes juridik në procedurën e prokurimit me titull:

"Sigurimi Fizik i Objekteve të Administratës së Përgjithshme, Objektivit të Arkivit Komunal në Drenas, Objektivit të Veçantë, Sigurimi Fizik i Objekteve – Gjimnazi "Skënderbeu" dhe SHMP e Teknikës "Fehmi Lladrovci",

me numër të prokurimit 611-26-2698-2-1-1, paraqet këtë:

ANKESË

kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues – Komuna e Drenasit, të datës 22.07.2026, me të cilin është refuzuar si e pabazuar Kërkesa për Rishqyrtim e Grupit të Operatorëve Ekonomikë MEB L.L.C. & KSF MAJOR SH.A., duke lënë në fuqi Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 16.07.2026, me të cilin oferta e Grupit të Operatorëve Ekonomikë MEB L.L.C. & KSF MAJOR SH.A. është shpallur e papërgjegjshme dhe është rekomanduar për dhënie të kontratës Grupi i Operatorëve Ekonomikë "Alfa Security SHPK & SIG SHPK".

Kjo ankesë parashtrohet për shkak se vendimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat imperative të Ligjit për Prokurimin Publik, Rregullores për Prokurimin Publik dhe dokumentacionit të tenderit, **duke cenuar rëndë parimet themelore të ligjshmërisë, trajtimit të barabartë, transparencës, proporcionalitetit, konkurrencës së lirë dhe efektive, si dhe sigurisë juridike.**

Vendimi kundërshtohet për shkak të:

1. Shkeljes së dispozitave materiale të Ligjit për Prokurimin Publik;
2. Shkeljes esenciale të dispozitave procedurale gjatë vlerësimit dhe rivlerësimit të ofertave;

3. Konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike;
4. Zbatimit selektiv dhe diskriminues të kriterëve të Dosjes së Tenderit ndaj operatorëve ekonomikë;
5. Mungesës së arsytimit të plotë juridik dhe faktik të vendimit administrativ, në kundërshtim me parimet e transparencës dhe llogaridhënies, duke pamundësuar kontrollin efektiv të ligjshmërisë së tij nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

II. SHKELJET THELBËSORE PROCEDURALE TË VENDIMIT TË AUTORITETIT KONTRAKTUES

Vendimi i Autoritetit Kontraktues është nxjerrë në kundërshtim me nenet **1, 7, 59, 60, 72, 108/A dhe 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik**, si dhe me dispozitat e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, pasi nuk përmban arsyetim të plotë faktik dhe juridik dhe nuk trajton në mënyrë individuale pretendimet e ngritura nga Ankuesi. Sipas nenit **7 të LPP-së**, Autoriteti Kontraktues është i obliguar të sigurojë trajtim të barabartë, mosdiskriminim, proporcionalitet dhe transparencë gjatë gjithë procedurës së prokurimit. Këto parime nuk kufizohen vetëm në fazën e vlerësimit të ofertave, por zbatohen edhe gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim. Po ashtu, sipas **nenit 59 të LPP-së**, Autoriteti Kontraktues ka detyrim që ofertat t'i vlerësojë vetëm në bazë të kriterëve dhe kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, ndërsa sipas **nenit 60 të LPP-së** është i obliguar të bëjë ekzaminim, vlerësim dhe krahasim objektiv të ofertave. Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk ka kryer fare një analizë objektive të pretendimeve të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim. Ankuesi ka ngritur shkelje konkrete lidhur me:

1. analizën financiare të operatorit ekonomik të rekomanduar;
2. mosrespektimin e kërkesave të Dosjes së Tenderit;
3. mosllogaritjen e kostove të detyrueshme sipas legjislacionit të punës;
4. mungesën e dokumentacionit të kërkuar;
5. trajtimin e pabarabartë të operatorëve ekonomikë.

Megjithatë, AK nuk ka dhënë përgjigje të veçantë për asnjërin nga këto pretendime. Vendimi nuk përmban analizë të provave, nuk identifikon bazën ligjore mbi të cilën mbështetet refuzimi dhe nuk shpjegon pse pretendimet e Ankuesit konsiderohen të pabazuara. Një vendim i tillë nuk plotëson standardin minimal të arsytimit që kërkohet nga një akt administrativ dhe bie ndesh me parimin e transparencës dhe llogaridhënies të garantuar nga neni **1 dhe neni 7 i LPP-së**. Mungesa e arsytimit për secilin pretendim përbën shkelje procedurale esenciale, pasi e bën të pamundur kontrollin e ligjshmërisë së vendimit nga Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe cenon të drejtën e Ankuesit për një mjet juridik efektiv, të garantuar me nenet **108/A dhe 109 të LPP-së**. Për më tepër, AK nuk ka arsyetuar pse ka pranuar dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar, ndërsa të njëjtat standarde nuk i ka zbatuar ndaj Ankuesit, duke vepruar në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë nga **neni 7 i LPP-së**.

III. INTERPRETIMI I GABUAR DHE NË KUNDËRSHTIM ME LIGJIN I STATUSIT TË ANKUESIT

Autoriteti Kontraktues pretendon se Grupi i Operatorëve Ekonomikë **MEB L.L.C. & KSF MAJOR SH.A.** nuk kishte ushtruar kërkesë për rishqyrtim ndaj vendimit të parë dhe, për këtë arsye, nuk gëzon të drejtën për të kontestuar vendimin aktual. Ky pretendim nuk mbështetet në asnjë dispozitë të Ligjit për Prokurimin Publik. As

neni 108/A, as neni 109 i LPP-së nuk parashikojnë humbjen e së drejtës për të ushtruar mjete juridike për shkak se operatori ekonomik nuk ka kontestuar një vendim paraprak që më pas është shfuqizuar ose ka humbur efektin juridik. Përkundrazi, me vendimin për kthimin e procedurës në rivlerësim, Autoriteti Kontraktues ka pranuar se procedura duhet të zhvillohet përsëri dhe se vendimi paraprak nuk prodhon më pasoja juridike. Rivlerësimi përbën një procedurë të re të vlerësimit, në të cilën Autoriteti Kontraktues është i detyruar, në bazë të **nenit 60 të LPP-së**, të bëjë ekzaminim dhe vlerësim të ri, të plotë, objektiv dhe të paanshëm të të gjitha ofertave. Si rezultat i këtij rivlerësimi është nxjerrë një vendim i ri administrativ, **i cili krijon pasoja të reja juridike për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë**. Pikërisht ky vendim i ri është objekt i kërkesës për rishqyrtim dhe i kësaj ankese. Interpretimi i Autoritetit Kontraktues se Ankuesi nuk mund të ushtrojë mjet juridik kundër një vendimi të ri është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenet 108/A dhe 109 të LPP-së dhe cenon parimin kushtetues të qasjes efektive në mjete juridike. Nëse do të pranohej ky interpretim, çdo Autoritet Kontraktues do të mund të shmangte kontrollin e ligjshmërisë së vendimeve të tij vetëm duke zhvilluar një rivlerësim dhe më pas duke pretenduar se operatorët ekonomikë nuk kanë më të drejtë ankimi. Një interpretim i tillë jo vetëm që nuk gjen mbështetje në LPP, por do ta bënte të pavlefshëm të gjithë mekanizmin e mbrojtjes juridike të parashikuar në nenet 108/A dhe 109. Grupi i Operatorëve Ekonomikë **MEB L.L.C. & KSF MAJOR SH.A.** është pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, ka interes të drejtpërdrejtë ekonomik dhe juridik në dhënien e kontratës dhe është dëmtuar nga vendimi i ri i Autoritetit Kontraktues. Për këtë arsye, ai ka legjitimitet të plotë aktiv për të ushtruar kërkesë për rishqyrtim dhe ankesë pranë OSHP-së. Për rrjedhojë, ky arsyetim i Autoritetit Kontraktues është jo vetëm i pabazuar në ligj, por përbën edhe shkelje të rëndë të parimit të ligjshmërisë, të parimit të trajtimit të barabartë sipas nenit 7 të LPP-së dhe të së drejtës së Ankuesit për mbrojtje juridike efektive sipas neneve 108/A dhe 109 të Ligjit për Prokurimin Publik. Për më tepër, pretendimi i Autoritetit Kontraktues se Ankuesi ka humbur të drejtën për të ushtruar mjete juridike për shkak se nuk ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim ndaj vendimit të parë është i pabazuar si në aspektin faktik ashtu edhe në atë juridik. Grupi i Operatorëve Ekonomikë **MEB L.L.C. & KSF MAJOR SH.A.**, në momentin e dorëzimit të ofertës, ka paraqitur një ofertë e cila, sipas Dosjes së Tenderit, ka qenë e vlefshme për **150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë** nga data e dorëzimit. Për rrjedhojë, gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës, Ankuesi ka ruajtur statusin e operatorit ekonomik pjesëmarrës dhe interesin e tij juridik për dhënien e kontratës. Mosushtimi i kërkesës për rishqyrtim ndaj vendimit të parë nuk mund të interpretohet si **heqje dorë nga e drejta për mjete juridike**. Interesi juridik i Ankuesit është cenuar drejtpërdrejt vetëm me nxjerrjen e vendimit të ri të Autoritetit Kontraktues, me të cilin kontrata i është rekomanduar një operatori ekonomik që, sipas provave të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim dhe në këtë ankesë, nuk i plotëson kërkesat administrative, dokumentare, teknike dhe ligjore të Dosjes së Tenderit dhe të Ligjit për Prokurimin Publik. Prandaj, e drejta e Ankuesit për të ushtruar kërkesë për rishqyrtim dhe ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit buron nga **vendimi i ri administrativ**, i cili prodhon pasoja të drejtpërdrejta juridike ndaj tij, dhe jo nga vendimi paraprak që ka humbur efektin juridik pas kthimit të procedurës në rivlerësim. Çdo interpretim tjetër do të ishte në kundërshtim me nenet 108/A dhe 109 të Ligjit për Prokurimin Publik, do të kufizonte në mënyrë të paligjshme të drejtën për mjete juridike efektive dhe do t'i lejonte Autoritetit Kontraktues të shmangte kontrollin e ligjshmërisë së vendimeve të tij përmes rivlerësimeve të njëpasnjëshme, gjë që bie ndesh me parimet e ligjshmërisë, transparencës, trajtimit të barabartë dhe mbrojtjes efektive juridike.

PRETENDIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES SE OPERATORI EKONOMIK ANKUES NUK ËSHTË PALË ME INTERES ËSHTË I PABAZUAR DHE NË KUNDËRSHTIM ME VENDIMIN E VETË AUTORITETIT KONTRAKTUES

Autoriteti Kontraktues ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim me arsyetimin se Grupi i Operatorëve Ekonomikë **MEB L.L.C. & KSF MAJOR SH.A.** nuk gëzon statusin e palës me interes, me pretendimin se nuk kishte

ushtruar mjet juridik kundër vendimit të parë të Autoritetit Kontraktues. Ky arsyetim është tërësisht i pabazuar, në kundërshtim me **nenet 105, 108/A dhe 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik**, bie ndesh me vetë vendimin e Autoritetit Kontraktues për kthimin e procedurës në rivlerësim dhe përbën interpretim arbitrar të ligjit.

1. Ligji nuk parasheh humbjen e së drejtës për mjete juridike

Asnjë dispozitë e Ligjit për Prokurimin Publik nuk parashikon se një operator ekonomik humbet të drejtën për të ushtruar kërkesë për rishqyrtim ose ankesë vetëm pse nuk ka kontestuar një vendim paraprak. Përkundrazi, **neni 108/A dhe neni 109 të LPP-së** garantojnë të drejtën e çdo operatori ekonomik që ka ose ka pasur interes për dhënien e kontratës dhe që pretendon se është dëmtuar nga një vendim, veprim ose mosveprim i Autoritetit Kontraktues në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik. Ligji nuk e kushtëzon në asnjë rast ushtrimin e mjeteve juridike me faktin nëse operatori ekonomik ka ushtruar ose jo mjete juridike ndaj një vendimi paraprak që më pas ka humbur efektin juridik. Për rrjedhojë, **Autoriteti Kontraktues nuk ka kompetencë të krijojë kushte shtesë që nuk janë të parashikuara në Ligj, pasi një veprim i tillë cenon parimin e ligjshmërisë dhe tejkalon kompetencat e tij ligjore.**

2. Vendimi i parë ka humbur efektin juridik

Vetë Autoriteti Kontraktues, me vendimin për kthimin e procedurës në rivlerësim, ka pranuar se procedura duhet të zhvillohet përsëri. Me marrjen e këtij vendimi, vendimi paraprak administrativ ka pushuar së prodhuari pasoja juridike dhe nuk mund të përdoret më si bazë për kufizimin e të drejtave procedurale të operatorëve ekonomikë. Për këtë arsye, pretendimi se Ankuesi duhej të kishte ushtruar mjet juridik kundër një vendimi që nuk prodhon më asnjë efekt juridik është i pabazuar dhe juridikisht i paqëndrueshëm.

3. Rivlerësimi është zhvilluar për të gjitha ofertat

Nga vetë vendimi i Autoritetit Kontraktues nuk rezulton askund se rivlerësimi është kufizuar vetëm për një operator ekonomik, vetëm për një pjesë të ofertave ose vetëm për pretendimet e një ankuesi të caktuar.

Në vendim nuk ekziston asnjë dispozitë që:

- përjashton ndonjë operator ekonomik nga rivlerësimi;
- kufizon objektin e rivlerësimit;
- kufizon të drejtën e operatorëve ekonomikë për mjete juridike;
- apo deklaron se ofertat e operatorëve të tjerë nuk do të rivlerësohen.

Përkundrazi, Komisioni i Vlerësimit ka bërë rivlerësimin e të gjitha ofertave dhe ka nxjerrë një **Raport të ri të Vlerësimit** dhe një **Vendim të ri mbi dhënien e kontratës**, duke ndryshuar pasojat juridike për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Ky fakt rrëzon plotësisht pretendimin e Autoritetit Kontraktues se vetëm Ankuesi nuk kishte të drejtë të kundërshtonte rezultatin e rivlerësimit.

4. Ankuesi ka pasur interes juridik gjatë gjithë procedurës

Në momentin e dorëzimit të ofertës, Grupi i Operatorëve Ekonomikë **MEB L.L.C. & KSF MAJOR SH.A.** ka

paraqitur një ofertë e cila, sipas Dosjes së Tenderit, ishte e vlefshme për **150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë** nga data e dorëzimit. Për rrjedhojë, gjatë gjithë kësaj periudhe Ankuesi ka ruajtur statusin e operatorit ekonomik pjesëmarrës dhe interesin juridik për dhënien e kontratës. Mosushtimi i kërkesës për rishqyrtim ndaj vendimit të parë nuk përbën heqje dorë nga e drejta për mjete juridike dhe nuk mund të interpretohet si humbje e interesit juridik. Në atë fazë procedurale, Ankuesi kishte të drejtë të vlerësonte nëse ushtrimi i mjetit juridik ishte në interesin e tij, duke pasur parasysh se një ankesë mund të rezultonte edhe me anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe ritenderimin e tij. Megjithatë, pasi Autoriteti Kontraktues, pas rivlerësimit, rekomandoi për dhënie të kontratës një operator ekonomik që, sipas pretendimeve dhe provave të paraqitura në këtë ankesë, **nuk i plotëson kërkesat administrative, dokumentare, teknike dhe ligjore të Dosjes së Tenderit**, Ankuesi u dëmtua drejtpërdrejt nga ky vendim i ri administrativ dhe ushtroi të drejtën e tij ligjore për mbrojtje juridike.

5. Interpretimi i AK-së cenon të drejtën për mjete juridike efektive

Interpretimi i Autoritetit Kontraktues krijon një kufizim që nuk ekziston në Ligjin për Prokurimin Publik. Nëse do të pranohej ky interpretim, çdo Autoritet Kontraktues do të mund të shmangte kontrollin e ligjshmërisë së vendimeve të tij vetëm duke kthyer procedurën në rivlerësim dhe më pas duke pretenduar se operatorët ekonomikë që nuk kanë kundërshtuar vendimin e parë nuk kanë më të drejtë ankimi. Një interpretim i tillë është në kundërshtim me **nenet 105, 108/A dhe 109 të LPP-së**, me parimet e **ligjshmërisë, transparencës, trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe mbrojtjes efektive juridike**, si dhe me vetë qëllimin e sistemit të mjeteve juridike në prokurimin publik. Për rrjedhojë, pretendimi i Autoritetit Kontraktues se Grupi i Operatorëve Ekonomikë **MEB L.L.C. & KSF MAJOR SH.A.** nuk është palë me interes është i **pabazuar në ligj**, kontradiktor me vendimin e vetë Autoritetit Kontraktues për rivlerësim dhe nuk mund të prodhojë asnjë pasojë juridike. Përkundrazi, ai përbën një shkelje të rëndë procedurale që, në vetvete, e bën vendimin e kontestuar të kundërligjshëm dhe përbën bazë të mjaftueshme për anulimin e tij nga Organi Shqyrtues i Prokurimit

IV. NDRYSHIMI ARBITRAR DHE I PAARSYETUAR I QËNDRIMIT TË AUTORITETIT KONTRAKTUES

Një nga shkeljet më të rënda materiale dhe procedurale të kryera nga Autoriteti Kontraktues në këtë procedurë është ndryshimi tërësisht arbitrar dhe i paarsyetuar i qëndrimit lidhur me përgjegjshmërinë e Grupit të Operatorëve Ekonomikë **Alfa Security SHPK & SIG SHPK**, pa ekzistuar asnjë ndryshim në gjendjen faktike, pa administruar prova të reja dhe pa dhënë asnjë arsytim juridik që do të justifikonte këtë ndryshim. Ky veprim është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me **nenet 1, 7, 59, 60, 61, 72, 105, 108/A dhe 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik**, me **Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative** Nga dokumentacioni zyrtar i procedurës rezulton se në **Raportin e parë të Vlerësimit dhe në Vendimin e parë të Autoritetit Kontraktues**, oferta e **GOE Alfa Security SHPK & SIG SHPK** ishte shpallur e **papërgjegjshme**, pasi analiza financiare nuk ka pasur ne oferte pas rivlerësimit AK ka kërkuar të mbulohet me sqarim kriterin obligativ pas përgjigjes OE rekomanduar për kontratë në analiza financiare nuk ishte përgatitur në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe nuk përmbante të gjitha elementet e detyrueshme të kostos së punës Autoriteti Kontraktues kishte konstatuar shprehimisht mungesën e elementeve që lidhen me pagesën e punës gjatë ndërrimeve të natës, punën gjatë festave zyrtare, pushimin vjetor dhe elemente të tjera të detyrueshme sipas Ligjit të Punës, akteve nënligjore dhe kërkesave të Dosjes së Tenderit. Megjithatë, pas rivlerësimit, **pa u ndryshuar oferta, pa u paraqitur analizë e re financiare, pa u dorëzuar dokumentacion shtesë, pa u lejuar korrigjimi i ofertës, pa u administruar prova të reja dhe pa u ndryshuar gjendja faktike**, i njëjti operator ekonomik është shpallur papritur **përgjegjshëm** dhe është rekomanduar për dhënie të kontratës. Nga **Raporti i**

Rivlerësimi të Tenderëve, të cilin Ankuesi e ka pranuar nga Autoriteti Kontraktues, rezulton se rivlerësimi është kryer pothuajse nga i njëjti Komision i Vlerësimit që kishte hartuar edhe raportin e parë. Pavarësisht kësaj, i njëjti komision ka arritur në një **përfundim diametralisht të kundërt mbi të njëjtin dokumentacion ofertues, pa dhënë asnjë shpjegim faktik ose juridik për këtë ndryshim.** Edhe më shqetësues është fakti se gjatë procedurës së rivlerësimit Ankuesi ka argumentuar në mënyrë të detajuar dhe me referenca konkrete në Dosjen e Tenderit, në Ligjin për Prokurimin Publik dhe në dokumentacionin e ofertës së GOE Alfa Security SHPK & SIG SHPK, se ekzistojnë mungesa të rëndësishme administrative, teknike dhe financiare, të cilat vazhdojnë të ekzistojnë edhe pas rivlerësimit. Ankuesi ka evidentuar me prova konkrete mungesat në dokumentacion, mospërputhjet në analizën financiare dhe mosplotësimin e kërkesave të Dosjes së Tenderit. Megjithatë, **Autoriteti Kontraktues nuk ka analizuar asnjërin prej këtyre pretendimeve**, nuk ka kundërshtuar provat e paraqitura dhe nuk ka dhënë asnjë arsytim se përse mangësitë që më parë i kishte konsideruar vendimtare për eliminim tani nuk përbëjnë më shkak për shpalljen e ofertës si të papërgjegjshme.

Autoriteti Kontraktues nuk ka shpjeguar:

- cilat mangësi janë eliminuar;
- kur janë eliminuar;
- me cilin dokument janë eliminuar;
- nëse është kërkuar sqarim sipas Ligjit për Prokurimin Publik;
- nëse është lejuar plotësim ose korrigjim i ofertës;
- mbi cilat prova është bazuar ndryshimi i vlerësimit;
- mbi bazën e cilit nen të Ligjit për Prokurimin Publik është ndryshuar përfundimi i mëparshëm.

Në mungesë të këtyre elementeve, vendimi është i paarsyetuar dhe përbën një akt administrativ arbitrar.

Sipas **nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik**, Autoriteti Kontraktues është i obliguar të bëjë ekzaminimin dhe vlerësimin e ofertave vetëm mbi bazën e dokumenteve të dorëzuara dhe kritereve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Sipas **nenit 60 të LPP-së**, ekzaminimi dhe vlerësimi duhet të jetë objektiv, i paanshëm dhe i bazuar vetëm në dokumentacionin e ofertës

SHKELJA E NENIT 10 TË LIGJIT PËR PROKURIMIN PUBLIK – MUNGESA E TRANSPARENCËS DHE E DOKUMENTIMIT TË VENDIMMARRJES

Neni 10 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik obligon Autoritetin Kontraktues që për secilin aktivitet të prokurimit të mbajë një dokumentacion të plotë, të rregullt dhe gjithëpërfshirës, i cili duhet të përmbajë të gjitha dokumentet, analizat dhe arsyetimet mbi të cilat mbështetet vendimmarrja. Ky detyrim nuk ka karakter formal, por garanton transparencën, llogaridhënien dhe mundësinë e kontrollit të ligjshmërisë së procedurës nga OSHP dhe palët e interesuara. Në rastin konkret, vendimi i Autoritetit Kontraktues nuk përmban **një analizë të plotë juridike dhe financiare mbi pretendimet e Ankuesit dhe nuk arsyeton mbi çfarë provash është mbështetur për të konsideruar ofertën e GOE të rekomanduar si të përgjegjshme**. Po ashtu, nuk është dhënë asnjë arsytim objektiv pse të njëjtat standarde të vlerësimit nuk janë zbatuar në mënyrë të barabartë ndaj të gjithë

operatorëve ekonomikë.

Mungesa e një dokumentimi dhe arsyetimi të plotë cenon drejtpërdrejt parimin e transparencës dhe e bën të pamundur kontrollin efektiv të ligjshmërisë së vendimit. Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 10 të Ligjit për Prokurimin Publik.

SHKELJA E NENIT 4, PARAGRAFI 1.36 TË LIGJIT PËR PROKURIMIN PUBLIK – PRANIMI I NJË TENDERIT TË PAPËRGJEGJSHËM

Neni 4 paragrafi 1.36 i Ligjit për Prokurimin Publik përkufizon qartë se tender i papërgjegjshëm është ai tender që nuk është në përputhje me Dosjen e Tenderit, kërkesat teknike dhe kontraktuale, legjislacionin relevant ose kërkesat e Autoritetit Kontraktues. Ky përkufizim përbën bazën ligjore mbi të cilën duhet të mbështetet vlerësimi i përgjegjshmërisë së çdo oferte. Në procedurën konkrete, Ankuesi ka argumentuar se oferta e GOE të rekomanduar nuk i përmbush kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit dhe se analiza financiare e saj nuk është në pajtim me kushtet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues dhe legjislacioni në fuqi. Pavarësisht këtyre mangësive, Autoriteti Kontraktues e ka konsideruar ofertën si të përgjegjshme pa kryer një analizë të plotë dhe të arsyetuar. Pranimi i një oferte që nuk i plotëson kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit bie ndesh me përkufizimin ligjor të nenit 4 paragrafi 1.36 dhe, rrjedhimisht, edhe me nenin 60 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili lejon dhënien e kontratës vetëm një tenderi të përgjegjshëm. Për këtë arsye, vendimi i Autoritetit Kontraktues është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe nuk mund të qëndrojë në fuqi, pasi mbështetet në pranimin e një oferte që nuk i plotëson kushtet ligjore dhe kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Po ashtu, neni 7 i LPP-së obligon Autoritetin Kontraktues të sigurojë trajtim të barabartë, transparencë, proporcionalitet dhe mosdiskriminim ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.

Ndërkohë, Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative obligon çdo organ publik që aktet administrative t'i bazojë në fakte të provuara, prova të administruara dhe arsyetim të plotë juridik. Autoriteti Kontraktues nuk mund të nxjerrë dy vendime diametralisht të kundërta mbi të njëjtën gjendje faktike pa shpjeguar se çfarë ka ndryshuar ndërmjet dy vendimeve. Në të kundërtën, cenohet rëndë parimi i ligjshmërisë, parimi i sigurisë juridike, parimi i pritshmërive legjitime, parimi i transparencës dhe parimi i trajtimit të barabartë, të cilat përbëjnë bazën e sistemit të prokurimit publik. Veçanërisht shqetësues është fakti se, ndonëse Ankuesi ka identifikuar dhe argumentuar me prova konkrete një numër të konsiderueshëm mangësish dhe mospërputhjesh në ofertën e GOE Alfa Security SHPK & SIG SHPK, Autoriteti Kontraktues ka zgjedhur të mos i trajtojë ato fare në Raportin e Rivlerësimit dhe në Vendimin mbi Kërkesën për Rishqyrtim. Kjo mënyrë e veprimit krijon dyshime serioze dhe objektive mbi paanshmërinë, objektivitetin dhe ligjshmërinë e procesit të rivlerësimit. Duke qenë se dokumentacioni i ofertës nuk ka ndryshuar, ndërsa rezultati i vlerësimit ka ndryshuar plotësisht pa asnjë arsyetim ligjor, krijohet bindja se vendimmarrja nuk është bazuar në kriteret objektive të Dosjes së Tenderit dhe të Ligjit për Prokurimin Publik, por në kriteret tjetra që nuk janë bërë transparente dhe nuk mund t'i nënshtrohen kontrollit të ligjshmërisë. Dëmton konkurrencën e ndershme dhe bie ndesh me qëllimin e nenit 1 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili synon përdorimin efikas të fondeve publike, garantimin e konkurrencës së drejtë dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë. Për rrjedhojë, rekomandimi për dhënien e kontratës GOE Alfa Security SHPK & SIG SHPK është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke

përbërë një vendim arbitrar, të paarsyetuar dhe të kundërligjshëm. Vetëm kjo shkelje është e mjaftueshme që Organi Shqyrtues i Prokurimit, në ushtrimin e kompetencave të tij sipas **nenit 105 të LPP-së**, të konstatojë paligjshmërinë e vendimit, ta anulojë atë dhe ta kthejë procedurën në një rivlerësim të ri, objektiv, transparent dhe në përputhje të plotë me Ligjin për Prokurimin Publik.

V. SHKELJA E NENIT 59 TË LIGJIT PËR PROKURIM PUBLIK

Autoriteti Kontraktues, gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, ka vepruar në kundërshtim të drejtpërdrejtë me **nenin 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik**, duke rekomanduar për dhënie të kontratës një operator ekonomik, oferta e të cilit nuk përmbush një numër të konsiderueshëm të kërkesave obligative të Dosjes së Tenderit. Neni 59 i LPP-së obligon Autoritetin Kontraktues që të bëjë një verifikim të plotë, objektiv dhe të bazuar vetëm në dokumentacionin e ofertës, me qëllim që të konstatojë nëse operatori ekonomik i përmbush të gjitha kërkesat administrative, profesionale, teknike dhe financiare të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Ky obligim është detyrues dhe nuk i jep Autoritetit Kontraktues të drejtën të tolerojë mungesa materiale, të anashkalojë kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit apo të lejojë plotësimin e kritereve të kualifikimit në kundërshtim me Ligjin dhe Rregulloren për Prokurimin Publik. Nga dokumentacioni i procedurës, oferta e **GOE Alfa Security SHPK & SIG SHPK**, Raporti i Vlerësimit, Raporti i Rivlerësimit dhe dokumentet që i bashkëngjiten kësaj Ankese, rezulton se operatori ekonomik i rekomanduar nuk i përmbush një numër të konsiderueshëm të kërkesave obligative të Dosjes së Tenderit, të cilat Autoriteti Kontraktues ishte i detyruar t'i verifikonte sipas nenit 59 të LPP-së.

1. Marrëveshja me Administratën Tatimore të Kosovës (ATK)

Nga dokumentacioni rezulton se hapja e tenderëve është zhvilluar më **24.04.2026**, ndërsa GOE i rekomanduar ka lidhur marrëveshjen me Administratën Tatimore të Kosovës për pagesën e detyrimeve tatimore vetëm më **05.05.2026**. Ky fakt ngre dyshime serioze nëse operatori ekonomik i ka përmbushur kriteret e kualifikimit në momentin kur ato duhej të ekzistonin sipas Ligjit dhe Dosjes së Tenderit. Interpretimi juridik i këtij fakti është i qartë: **një dokument i krijuar pas zhvillimit të procedurës nuk mund të ketë efekt retroaktiv për të provuar përmbushjen e një kriteri që duhej të ekzistonte paraprakisht**, përveç nëse Ligji ose Dosja e Tenderit e lejojnë shprehimisht një gjë të tillë. Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues ka qenë i detyruar të verifikojë momentin e plotësimit të këtij kriteri dhe të arsyetojë ligjërisht pranueshmërinë e kësaj marrëveshjeje. Mosveprimi i tij përbën shkelje të nenit 59 të LPP-së.

2. Plotësimi i dokumenteve përmes procedurës së sqarimit

Nga dokumentacioni i procedurës rezulton se GOE i rekomanduar ka dorëzuar dokumente të cilat nuk kanë qenë pjesë e ofertës fillestare, por janë paraqitur vetëm pas kërkesës së Autoritetit Kontraktues për sqarime. Megjithatë, dokumentet që dëshmojnë **kapacitetin administrativ, profesional dhe teknik**, kur janë kërkuar si kushte obligative në Dosjen e Tenderit, duhet të jenë pjesë e ofertës brenda afatit për dorëzimin e saj. Procedura e sqarimit nuk mund të përdoret për të krijuar ose plotësuar dokumente që mungonin në ofertën fillestare, pasi kjo bie ndesh me nenin 59 të LPP-së dhe me dispozitat e **Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik**, e cila lejon vetëm sqarimin e dokumenteve **ekzistuese dhe jo zëvendësimin apo krijimin e dokumenteve të reja që ndikojnë në përmbushjen e kritereve të kualifikimit.**

3. Analiza financiare nuk është në përputhje me Dosjen e Tenderit

Dosja e Tenderit ka kërkuar në mënyrë obligative që analiza financiare të përfshijë të gjitha elementet e kostos së punës në përputhje me Ligjin e Punës. Megjithatë, në analizën financiare të GOE të rekomanduar, elementet për:

- punën gjatë natës;
- punën gjatë fundjavës;
- punën gjatë festave zyrtare;
- pushimin vjetor,

janë paraqitur me vlerë 0 (zero) ose nuk janë llogaritur fare, ndonëse **këto elemente janë kërkuar shprehimisht nga Dosja e Tenderit**. Për rrjedhojë, analiza financiare nuk pasqyron koston reale të ekzekutimit të kontratës dhe nuk është në përputhje me kërkesat obligative të FDT-së. Mosverifikimi i kësaj mangësie nga Autoriteti Kontraktues përbën shkelje të nenit 59 të LPP-së.

4. Dokumentacioni për automjetet

Dosja e Tenderit ka kërkuar dëshmi të vlefshme për disponueshmërinë e automjeteve. Megjithatë, për njërin nga automjetet e deklaruar, marrëveshja e përdorimit nuk është nënshkruar nga personi që figuron si pronar në lejen e qarkullimit të automjetit (Raiffesen Bank) Për pasojë, mungon prova juridike që operatori ekonomik gëzon të drejtën ligjore për përdorimin e këtij automjeti gjatë realizimit të kontratës. Autoriteti Kontraktues, në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, nuk e ka verifikuar këtë mangësi.

5. Dokumentacioni i stafit dhe mungesa e organogramit

Lista e stafit është nënshkruar nga lideri i grupit, ndërsa kartelat dhe dokumentacioni identifikues i punonjësve janë lëshuar nga një subjekt tjetër si dhe prej 10 personave 8 tyre ekan pavalidë Po ashtu, mungon **organogrami**, ndonëse ai është kërkuar si dokument obligativ në Dosjen e Tenderit. Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsye se si këto dokumente i konsideron në përputhje me kërkesat e FDT-së, duke mos përmbushur detyrimin e verifikimit sipas nenit 59 të LPP-së.

6. Mungesa e deklaratave obligative

Në kundërshtim me **Kërkesën nr. 6 të Dosjes së Tenderit**, GOE i rekomanduar nuk ka dorëzuar deklaratat e kërkuara lidhur me:

- respektimin e pagës minimale;
- respektimin e Ligjit të Punës;
- përmbushjen e obligimeve që burojnë nga legjislacioni i punës.

Këto deklarata janë kërkuar si dokumente obligative nga vetë Autoriteti Kontraktues dhe mungesa e tyre nuk mund të konsiderohet mangësi formale apo të plotësohet pas afatit të ofertimit. Është me rëndësi të theksohet se **të gjitha pretendimet e lartcekura janë ngritur fillimisht në Kërkesën për Rishqyrtim**, mirëpo Autoriteti Kontraktues nuk i ka trajtuar në mënyrë individuale, nuk ka dhënë përgjigje të arsyetuara për secilin pretendim

dhe nuk ka kundërshtuar me asnjë provë argumentet e paraqitura nga Ankuesi. **Për secilin nga pretendimet e mësipërme, Ankuesi i bashkëngjit kësaj Ankese provat materiale përkatëse, përfshirë pjesët relevante të Dosjes së Tenderit, ofertën e GOE Alfa Security SHPK & SIG SHPK, dokumentacionin administrativ, analizën financiare, dokumentet për automjetet, listën e stafit, marrëveshjen me ATK dhe çdo dokument tjetër që provon mospërputhjen e ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar me kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit.** Për rrjedhojë, është evidente se Autoriteti Kontraktues nuk ka kryer verifikimin e kërkuar nga **neni 59 i Ligjit për Prokurimin Publik**, por ka shpallur përgjegjshëm një operator ekonomik pa provuar se oferta e tij përmbush të gjitha kushtet obligative të Dosjes së Tenderit. Një veprim i tillë cenon ligjshmërinë e procedurës së prokurimit dhe përbën bazë të mjaftueshme ligjore që **Organi Shqyrtues i Prokurimit** të konstatojë shkeljen e nenit 59 të LPP-së, të anulojë vendimin e kontestuar dhe ta kthejë procedurën në rivlerësim në përputhje me ligjin.

VI. KONTRADIKTA E BRENDSHME E VENDIMIT TË AUTORITETIT KONTRAKTUES LIDHUR ME KALKULATORIN E ATK-së

Një nga shkeljet më të rënda të kryera nga Autoriteti Kontraktues në këtë procedurë është fakti se, ndonëse vetë ka vendosur një kriter të qartë, të detyrueshëm dhe eliminues në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, gjatë fazës së ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave ai ka dështuar ta zbatojë atë ndaj GOE Alfa Security SHPK & SIG SHPK, duke vepruar në kundërshtim me **nenin 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik**.

Në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar shprehimisht si kërkesë obligative:

"Dëshmit të prezantojë një analizë financiare për pagën bazë 500 € bruto të pasqyruar me të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 si dhe ATK-së. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë analizë financiare me shkrim se si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar, ku kjo analizë duhet të përfshijë së paku: pagën bazë bruto 500 €, pagesat shtesë për ndërrimet e natës dhe festat shtetërore, pushimet vjetore, trustin pensional, obligimet e punëdhënësit, TVSH-në dhe totalin e ofertës."

Kjo dispozitë nuk është rekomandim, udhëzim apo kriter orientues. Është kusht obligativ i vendosur nga vetë Autoriteti Kontraktues, i cili, sipas nenit 59 të LPP-së, është i detyruar ta zbatojë në mënyrë të njëjtë ndaj çdo operatori ekonomik. Megjithatë, nga analiza financiare e GOE Alfa Security SHPK & SIG SHPK rezulton qartë se **nuk janë përfshirë të gjitha elementet që Autoriteti Kontraktues i kishte kërkuar si kushte obligative, përkatësisht:**

- nuk është përfshirë **kontributi pensional (5%) në barrë të punëdhënësit**, fakt që pranohet edhe nga vetë Autoriteti Kontraktues në vendimin e tij;
- nuk janë llogaritur pagesat për **punën gjatë natës**;
- nuk janë llogaritur pagesat për **punën gjatë festave shtetërore**;
- nuk janë llogaritur **pushimet vjetore, fitimi ndonëse të gjitha këto elemente janë kërkuar shprehimisht në**

Dosjen e Tenderit.

Pra, vetë Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se analiza financiare **nuk përmban një element të detyrueshëm**, ndërsa dokumentacioni i ofertës dëshmon se mungojnë edhe elemente të tjera të kërkuara nga Dosja e Tenderit. Pavarësisht kësaj, ai ka arritur në përfundimin se oferta është e përgjegjshme. Ky arsyetim është **juridiksht i paqëndrueshëm dhe vetëkontradiktor**. Autoriteti Kontraktues **nuk mund të vendosë një kriter si obligativ në Dosjen e Tenderit dhe më pas, gjatë vlerësimit, ta injorojë mosplotësimin e atij kriteri**. Një veprim i tillë përbën shkelje të drejtpërdrejtë të **nenit 59 të LPP-së**, sepse ky nen e obligon Autoritetin Kontraktues të verifikojë nëse oferta përmbush **të gjitha** kërkesat e Dosjes së Tenderit, e jo vetëm ato që ai zgjedh t'i zbatojë. Nëse Autoriteti Kontraktues ka konsideruar se këto elemente nuk kanë qenë të rëndësishme, atëherë **nuk ka pasur të drejtë t'i vendoste si kushte obligative në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë**. Ndërsa, pasi i ka shpallur si kushte obligative, ai ka qenë i detyruar t'i zbatojë njësoj për të gjithë operatorët ekonomikë. Mosveprimi i Autoritetit Kontraktues ka sjellë një situatë ku **kriteret e Dosjes së Tenderit janë zbatuar vetëm formalisht në fazën e publikimit, por jo edhe në fazën e vlerësimit**, duke cenuar rëndë integritetin e procedurës së prokurimit. Edhe më e rëndë është fakti se **Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim ligjor** se përse një analizë financiare që nuk përmban elementet obligative të kërkuara nga vetë Dosja e Tenderit është konsideruar si e pranueshme. Në vendim nuk citohet **asnjë dispozitë e Ligjit për Prokurimin Publik, asnjë dispozitë e Rregullores për Prokurimin Publik dhe asnjë dispozitë e Dosjes së Tenderit** që do ta autorizonte Autoritetin Kontraktues të mos zbatojë kriteret që vetë i ka vendosur.

Përkundrazi, me këtë veprim Autoriteti Kontraktues ka ndryshuar në mënyrë të njëanshme kushtet e procedurës pas hapjes së ofertave, duke i dhënë operatorit ekonomik të rekomanduar një përfitim që nuk u është dhënë operatorëve të tjerë ekonomikë.

Për këtë pretendim, Ankuesi i bashkëngjijtë kësaj Ankese si prova materiale:

- Dosjen e Tenderit;
- Njoftimin për Kontratë;
- analizën financiare të GOE Alfa Security SHPK & SIG SHPK;
- vendimin e Autoritetit Kontraktues;
- si dhe dokumentacionin tjetër përkatës, nga të cilat vërtetohet se kriteri ishte **obligativ**, se operatori ekonomik i rekomanduar **nuk e ka përmbushur**, ndërsa Autoriteti Kontraktues, në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, e ka shpallur atë përgjegjës pa asnjë bazë ligjore.

Për rrjedhojë, vendimi i Autoritetit Kontraktues është i **kundërligjshëm, arbitrar dhe në kundërshtim me nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik**, pasi është nxjerrë duke mos zbatuar kriteret obligative të Dosjes së Tenderit të hartuara nga vetë Autoriteti Kontraktues.

VII. SHKELJA E NENIT 69 TË LIGJIT PËR PROKURIM PUBLIK – NDALIMI I NDRYSHIMIT TË ELEMENTEVE MATERIALE TË OFERTËS

Shkelja e nenit 69 të LPP-së manifestohet po ashtu në mënyrën se si Autoriteti Kontraktues ka trajtuar analizën financiare të GOE Alfa Security SHPK & SIG SHPK.

Në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar si **kërkesë obligative**:

"Dëshmit të prezantojë një analizë financiare për pagën bazë 500 € bruto të pasqyruar me të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 si dhe ATK-së. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë analizë financiare me shkrim se si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar, ku kjo analizë duhet të përfshijë së paku: pagën bazë bruto 500 €, pagesat shtesë për ndërrimet e natës dhe festat shtetërore, pushimet vjetore, trustin pensional, obligimet e punëdhënësit, TVSH-në dhe totalin e ofertës."

Kjo kërkesë është përcaktuar nga vetë Autoriteti Kontraktues si **kusht obligativ** dhe, si e tillë, është dashur të përmbushet në momentin e dorëzimit të ofertës. Autoriteti Kontraktues nuk ka kompetencë që, pas hapjes së ofertave, të lejojë plotësimin ose korrigjimin e analizës financiare përmes procedurës së sqarimit. Nga oferta fillestare e GOE Alfa Security SHPK & SIG SHPK rezulton se analiza financiare **nuk përmbante të gjitha elementet obligative** të kërkuara nga Dosja e Tenderit. Konkretisht, mungonin ose ishin paraqitur në kundërshtim me kërkesat e FDT-së elemente si:

- kontributi pensional (5%) në barrë të punëdhënësit;
- pagesat për punën gjatë natës;
- pagesat për punën gjatë fundjavës;
- pagesat për festat shtetërore;
- pushimet vjetore;
- elemente të tjera të detyrueshme të kostos të kërkuara nga Dosja e Tenderit.

Pavarësisht këtyre mangësive materiale, Autoriteti Kontraktues ka pranuar sqarimet e operatorit ekonomik dhe është mbështetur në to për ta konsideruar analizën financiare të pranueshme. Një veprim i tillë bie ndesh drejtpërdrejt me **nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik**, sepse procedura e sqarimit nuk mund të përdoret për të plotësuar ose korrigjuar elemente materiale të analizës financiare. Sqarimi mund të shërbejë vetëm për të shpjeguar një informacion tashmë ekzistues në ofertë, por **nuk mund të zëvendësojë elemente që mungojnë, nuk janë llogaritur ose nuk janë përfshirë fare në analizën financiare**. Në të kundërtën, do të lejohej që një operator ekonomik të paraqiste një analizë financiare të paplotë ose artificialisht më të ulët gjatë ofertimit dhe ta plotësonte ose justifikonte atë vetëm pasi të njihte ofertat e operatorëve të tjerë ekonomikë. Një praktikë e tillë cenon rëndë **barazinë e trajtimit, transparencën, integritetin e procedurës së prokurimit dhe konkurrencën e ndershme**. Është veçanërisht domethënës fakti se **vetë Autoriteti Kontraktues**, në vendimin e tij, pranon se analiza financiare e GOE të rekomanduar nuk përfshin **kontributin pensional prej 5% në barrë të punëdhënësit**, megjithatë arrin në përfundimin se oferta është e përgjegjshme. Ky është një arsyetim vetëkontradiktor, pasi pranohet ekzistenca e një mangësie materiale, por pa u dhënë asnjë bazë ligjore se përse kjo mangësi nuk ndikon në përgjegjshmërinë e ofertës.

Ankuesi i bashkëngjit kësaj Ankese si prova materiale:

- Dosjen e Tenderit;
- Njoftimin për Kontratë;

- analizën financiare të GOE Alfa Security SHPK & SIG SHPK;
- kërkesën për sqarime dhe përgjigjen e operatorit ekonomik;
- vendimin e Autoritetit Kontraktues;
- si dhe dokumentacionin tjetër përkatës,

nga të cilat vërtetohet se analiza financiare nuk i përmbushte kërkesat obligative të FDT-së në momentin e ofertimit dhe se Autoriteti Kontraktues ka lejuar në mënyrë të kundërligjshme justifikimin dhe korrigjimin e mangësive materiale përmes procedurës së sqarimit, në kundërshtim me **nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik**. Një ndryshim i tillë nuk është më "**sqarim**" në kuptimin e nenit 69 të LPP-së, por përbën **korrigjim dhe plotësim të ofertës**, gjë që ligji e ndalon shprehimisht. Për më tepër, nga dokumentacioni rezulton se përmes procedurës së sqarimit janë dorëzuar edhe dokumente që lidhen me **kapacitetin administrativ dhe teknik**, ndonëse këto dokumente është dashur të ishin pjesë e ofertës fillestare. Edhe në këtë aspekt, Autoriteti Kontraktues ka tejkaluar kompetencat e nenit 69 të LPP-së, pasi procedura e sqarimit nuk mund të përdoret për të krijuar ose plotësuar dokumentacion që mungonte në momentin e ofertimit. Në këtë mënyrë, Autoriteti Kontraktues i ka dhënë GOE Alfa Security SHPK & SIG SHPK një mundësi që nuk u është dhënë operatorëve të tjerë ekonomikë, duke i krijuar një **avantazh të padrejtë** pas përfundimit të afatit për dorëzimin e ofertave dhe duke cenuar rëndë parimin e barazisë së trajtimit në procedurat e prokurimit publik. Nëse do të pranohej një praktikë e tillë, çdo operator ekonomik do të mund të paraqiste një ofertë me mangësi materiale, me analizë financiare të paplotë ose me dokumentacion të papërfunduar, dhe më pas t'i plotësonte ose korrigjonte ato vetëm pasi të kërkohej sqarime nga Autoriteti Kontraktues. Një interpretim i tillë do ta bënte të pakuptimtë afatin ligjor për dorëzimin e ofertave, do të cenonte sigurinë juridike dhe do të rrëronte parimet themelore të prokurimit publik. Është me rëndësi të theksohet se **Ankuesi i ka ngritur të gjitha këto pretendime në Kërkesën për Rishqyrtim**, ndërsa në këtë Ankesë i argumenton përsëri dhe i bashkëngjijt si prova materiale:

- Dosjen e Tenderit;
- Njoftimin për Kontratë;
- kërkesat për sqarim dhe përgjigjet e GOE Alfa Security SHPK & SIG SHPK;
- analizën financiare të operatorit ekonomik të rekomanduar;
- dokumentacionin administrativ dhe teknik të dorëzuar pas kërkesës për sqarim;
- Raportin e Vlerësimit;
- Raportin e Rivlerësimit;
- vendimin e Autoritetit Kontraktues;
- si dhe dokumentet e tjera përkatëse që dëshmojnë se procedura e sqarimit është përdorur për të justifikuar dhe korrigjuar mangësi materiale të ofertës.

Për rrjedhojë, është evidente se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me **nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik**, duke lejuar në mënyrë të kundërligjshme plotësimin dhe korrigjimin e elementeve materiale të ofertës pas hapjes së tenderëve. Ky veprim cenon ligjshmërinë, integritetin dhe transparencën e procedurës së prokurimit. Për këtë arsye, vendimi i tij është i kundërligjshëm dhe duhet të anulohet.

VIII. SHKELJA E PARIMIT TË TRAJTIMIT TË BARABARTË DHE MOSDISKRIMINIMIT – NENI 7 I LPP-së

Një nga shkeljet më të rënda të kryera nga Autoriteti Kontraktues në këtë procedurë është shkelja e **nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik**, i cili obligon çdo Autoritet Kontraktues të sigurojë trajtim të barabartë, të paanshëm, proporcional dhe jodiskriminues ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë gjatë gjithë procedurës së prokurimit. Ky parim nuk është vetëm një deklaratë programatike, por **garancia themelore kushtetuese dhe ligjore** që siguron se fituesi i kontratës përcaktohet mbi **bazën e kriterëve objektive dhe të njëjta për të gjithë operatorët ekonomikë. Autoriteti Kontraktues nuk ka asnjë diskrecion ligjor të aplikojë standarde të ndryshme vlerësimi për operatorë të ndryshëm në të njëjtën procedurë.** Në rastin konkret, pikërisht këtë ka bërë Autoriteti Kontraktues. Nga njëra anë, ndaj një operatori ekonomik janë zbatuar kriteret e Dosjes së Tenderit në mënyrë rigoroze dhe formale, ndërsa ndaj GOE Alfa Security SHPK & SIG SHPK të njëjtat kriteret janë relativizuar, shpërfillur ose interpretuar në mënyrë krejtësisht të ndryshme. Ky trajtim selektiv vërtetohet nga vetë dokumentacioni i procedurës. Autoriteti Kontraktues ka konsideruar se moslogaritja e elementeve të analizës financiare përbën mangësi materiale kur ka vlerësuar ofertën e një operatori ekonomik tjetër, ndërsa ndaj GOE të rekomanduar ka pranuar një analizë financiare e cila nuk përmbush kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit, ndonëse vetë Dosja e Tenderit kërkonte shprehimisht që analiza financiare të përfshinte:

- pagën bazë prej 500 € bruto;
- kontributin pensional në barrë të punëdhënësit;
- pagesat për ndërrimet e natës;
- pagesat për punën gjatë fundjavës;
- pagesat për festat shtetërore;
- pushimin vjetor;
- obligimet e punëdhënësit;
- TVSH-në;
- dhe totalin e ofertës.

Megjithatë, përkundër mungesës së këtyre elementeve, Autoriteti Kontraktues e ka konsideruar ofertën si të përgjegjshme. Nuk mbaron me kaq. Autoriteti Kontraktues ka pranuar edhe dokumente të dorëzuara vetëm gjatë procedurës së sqarimit për pajisjet, automjetet dhe dokumentacionin teknik, ndonëse këto dokumente nuk kanë qenë pjesë e ofertës fillestare, duke shkelur njëkohësisht edhe nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Pra, për GOE të rekomanduar është lejuar:

- plotësimi i analizës financiare;
- justifikimi i mangësive materiale;
- dorëzimi i dokumenteve që mungonin;
- interpretimi fleksibil i kriterëve të Dosjes së Tenderit;
- pranimi i dokumenteve pas afatit të ofertimit.

Ndërsa operatorët e tjerë ekonomikë janë vlerësuar mbi bazën e dokumenteve të dorëzuara brenda afatit ligjor dhe janë eliminuar për mangësi shumë më të vogla. Ky nuk është më ushtrim i diskrecionit administrativ. Ky është **trajtim i pabarabartë, favorizim i operatorit ekonomik të rekomanduar dhe zbatim selektiv i Ligjit për Prokurimin Publik.** Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsytim juridik se përse një kriter është

konsideruar eliminues për një operator ekonomik, ndërsa i njëjti kriter nuk është konsideruar relevant për operatorin ekonomik që është rekomanduar për kontratë.

Një qasje e tillë është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me:

- **nenin 7** të Ligjit për Prokurimin Publik;
- parimin e konkurrencës së lirë dhe të ndershme;
- parimin e proporcionalitetit;
- parimin e trajtimit të barabartë;
- parimin e mosdiskriminimit;
- parimin e transparencës;
- parimin e ligjshmërisë.

Në praktikë, Autoriteti Kontraktues ka krijuar **dy sisteme të ndryshme vlerësimi brenda së njëjtës procedurë: Sistemi i parë**, i cili është aplikuar ndaj operatorëve të tjerë ekonomikë, ku çdo mangësi është konsideruar arsye eliminimi.

Sistemi i dytë, i cili është aplikuar vetëm ndaj GOE të rekomanduar, ku mangësitë materiale janë toleruar, dokumentet janë plotësuar pas ofertimit, analiza financiare është justifikuar përmes sqarimeve dhe kriteret obligative të Dosjes së Tenderit nuk janë zbatuar. Një praktikë e tillë cenon rëndë integritetin e procedurës së prokurimit dhe krijon bindjen e arsyeshme se kriteret nuk janë zbatuar në mënyrë të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë. Pasoja është konkrete. Operatori ekonomik që ka përlogaritur të gjitha obligimet ligjore dhe ka paraqitur ofertë në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit është penalizuar, ndërsa operatori ekonomik që nuk ka përmbushur të njëjtat kërkesa është shpërblyer me rekomandim për kontratë. Ky nuk është rezultat i konkurrencës së lirë. Ky është rezultat i **zbatimit selektiv të ligjit**, gjë që është e papranueshme në një procedurë të prokurimit publik. Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues ka shkelur rëndë **nenin 7** të Ligjit për Prokurimin Publik, duke cenuar barazinë e operatorëve ekonomikë, konkurrencën e ndershme, transparencën dhe besimin në sistemin e prokurimit publik. Kjo shkelje, e marrë së bashku me shkeljet e **neneve 59 dhe 69 të LPP-së**, përbën bazë të mjaftueshme ligjore që Organi Shqyrtues i Prokurimit të anulojë vendimin e kontestuar dhe ta kthejë procedurën në rivlerësim.

IX. SHKELJA E PARIMIT TË TRANSPARENCËS, ARSYETIMIT TË VENDIMIT, SIGURISË JURIDIKE DHE ADMINISTRIMIT TË MIRË

Vendimi i Autoritetit Kontraktues nuk është vetëm i gabuar në përmbajtje, por është edhe **proceduralisht i paligjshëm**, pasi nuk përmbush standardet minimale të arsyetimit të kërkuara nga Ligji për Prokurimin Publik dhe nga Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Një vendim administrativ që cenon të drejtat e operatorëve ekonomikë duhet të jetë i arsyetuar në mënyrë të plotë, logjike dhe të verifikueshme. Arsyetimi nuk është formalitet, por garanci kundër arbitraritetit dhe mjet që mundëson kontrollin efektiv të ligjshmërisë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit. Në rastin konkret, vendimi i kontestuar nuk përmban përgjigje për çështjet thelbësore të ngritura nga Ankuesi.

Autoriteti Kontraktues nuk ka shpjeguar:

- pse ka ndryshuar qëndrimin nga raporti i parë në raportin e rivlerësimit pa ndryshuar oferta;
- pse dokumentet e dorëzuara vetëm gjatë sqarimeve janë konsideruar të pranueshme;
- pse nuk është zbatuar neni 69 i LPP-së;
- pse nuk janë zbatuar kriteret obligative të Dosjes së Tenderit;
- pse analiza financiare, megjithëse nuk përmbush kërkesat obligative, është konsideruar e pranueshme;
- pse janë toleruar mangësi materiale vetëm për GOE të rekomanduar;
- pse pretendimet e Ankuesit, të mbështetura me prova konkrete, nuk janë analizuar një nga një.

Vendimi nuk përmban analizë juridike, nuk ballafaqon provat e paraqitura nga Ankuesi dhe nuk jep arsye pse ato janë refuzuar. Në vend të kësaj, ai përmban konkluzione të përgjithshme dhe deklarative që nuk i lejojnë OSHP-së të ushtrojë kontroll efektiv mbi ligjshmërinë e veprimeve të Autoritetit Kontraktues. Një vendim pa arsyetim të plotë është, në thelb, një vendim arbitrar. Ai cenon sigurinë juridike, transparencën dhe të drejtën e operatorëve ekonomikë për mbrojtje efektive, duke e bërë të pamundur verifikimin nëse ligji është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Në këto rrethana, vendimi i Autoritetit Kontraktues nuk mund të mbetet në fuqi. Mungesa e arsytimit, trajtimi selektiv i operatorëve ekonomikë, **mosbatimi i kriterëve obligative të Dosjes së Tenderit dhe lejimi i korigjimit të ofertës pas afatit për dorëzim përbëjnë së bashku shkelje serioze të Ligjit për Prokurimin Publik, të cilat e bëjnë vendimin të paligjshëm dhe imponojnë anulimin e tij dhe kthimin e procedurës në rivlerësim në përputhje me ligjin.** Neni 1 i Ligjit për Prokurimin Publik përcakton se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë përdorimin efikas, ekonomik, transparent dhe të drejtë të fondeve publike, duke garantuar një proces të drejtë, konkurrues dhe të bazuar në ligj. Në rastin konkret, ky qëllim është cenuar rëndë. Autoriteti Kontraktues nuk ka zhvilluar një procedurë në të cilën fiton operatori ekonomik që ka përmbushur kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe të legjislacionit në fuqi, por ka shpallur fitues një operator ekonomik që nuk ka përfshirë në analizën financiare të gjitha kostot obligative dhe që ka plotësuar mangësi materiale vetëm pas procedurës së sqarimeve. Një procedurë e tillë nuk siguron përdorim efikas dhe të drejtë të fondeve publike, por krijon avantazh të padrejtë për operatorët ekonomikë që nuk respektojnë kërkesat obligative të dokumentacionit të tenderit. Prandaj, vendimi i Autoritetit Kontraktues është në kundërshtim edhe me vetë qëllimin themelor të Ligjit për Prokurimin Publik.

Neni 53 i Ligjit për Prokurimin Publik ka për qëllim t'u mundësojë operatorëve ekonomikë të kërkojnë ose të marrin sqarime lidhur me dokumentacionin e tenderit dhe elementet e ofertës, por jo të ndryshojnë përmbajtjen materiale të saj. Në rastin konkret, **procedura e sqarimeve është përdorur për të mbuluar mangësi materiale të ofertës së GOE të rekomanduar. Nga dokumentacioni i procedurës rezulton se pas dorëzimit të ofertës janë paraqitur dokumente shtesë dhe janë dhënë sqarime që në thelb kanë shërbyer për të plotësuar mangësi në analizën financiare dhe dokumentacionin teknik.** Një përdorim i tillë i procedurës së sqarimeve bie ndesh me qëllimin e nenit 53 dhe cenon integritetin e procedurës së prokurimit. Procedura e sqarimeve nuk mund të përdoret si mekanizëm për ta bërë të përgjegjshme një ofertë që në momentin e dorëzimit nuk i përmbushte kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit. Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 53 të Ligjit për Prokurimin Publik, duke lejuar që procedura e sqarimeve të shndërrohet në procedurë të plotësimit dhe korigjimit të ofertës, gjë që cenon barazinë, transparencën dhe ligjshmërinë e procedurës së prokurimit.

X. ANALIZA FINANCIARE E OPERATORIT EKONOMIK TË REKOMANDUAR NUK ËSHTË NË PËRPUTHJE ME DOSJEN E TENDERIT DHE LEGJISLACIONIN NË FUQI

Një nga shkeljet më të rënda dhe vendimtare në këtë procedurë lidhet me faktin se **analiza financiare e GOE**

Alfa Security SHPK & SIG SHPK nuk i përmbush kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit dhe të Njoftimit për Kontratë, megjithatë Autoriteti Kontraktues e ka konsideruar atë të pranueshme dhe e ka shpallur operatorin ekonomik fitues, në kundërshtim me **nenin 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik.**

Në **Dosjen e Tenderit** dhe në **Njoftimin për Kontratë**, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar si **kusht obligativ** kërkesën:

"Dëshmit të prezantojë një analizë financiare për pagën bazë 500 € bruto të pasqyruar me të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 si dhe ATK-së. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë analizë financiare me shkrim se si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar, ku kjo analizë duhet të **përfshijë së paku: pagën bazë bruto 500 €, pagesat shtesë për ndërrimet e natës dhe festat shtetërore, pushimet vjetore, trustin pensional, obligimet e punëdhënësit, TVSH-në dhe totalin e ofertës.**"

Kjo kërkesë nuk është fakultative, orientuese apo deklarative. **Ajo përbën kriter obligativ të kualifikimit teknik dhe financiar,** të vendosur nga vetë Autoriteti Kontraktues, i cili ishte i detyruar ta zbatojë në mënyrë të njëjtë ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.

Qëllimi i kësaj analize financiare është të mundësojë verifikimin objektiv nëse çmimi i ofertuar është ndërtuar mbi baza reale ekonomike dhe juridike, në përputhje me **Ligjin e Punës, legjislacionin tatimor, dispozitat mbi kontributet pensionale** dhe detyrimet e tjera ligjore që lidhen me ekzekutimin e kontratës.

Analiza financiare nuk është një dokument formal. Ajo përbën bazën mbi të cilën Autoriteti Kontraktues vlerëson nëse operatori ekonomik është realisht në gjendje ta realizojë kontratën duke respektuar të gjitha detyrimet ligjore ndaj punëtorëve dhe shtetit.

Megjithatë, nga analiza financiare e GOE Alfa Security SHPK & SIG SHPK rezulton se ajo **nuk përfshin të gjitha elementet obligative të kërkuara nga Dosja e Tenderit,** ndër të cilat:

- mungon kontributi pensional prej **5% në barrë të punëdhënësit;**
- nuk janë përlogaritur pagesat për punën gjatë natës;
- nuk janë përlogaritur pagesat për punën gjatë festave zyrtare;
- nuk janë përlogaritur pagesat për punën gjatë fundjavave;
- nuk janë përlogaritur pushimet vjetore;
- si dhe elemente të tjera të detyrueshme të kostos që vetë Autoriteti Kontraktues i kishte kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Këto nuk janë lëshime formale apo gabime aritmetike.

Këto janë elemente materiale të analizës financiare, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në çmimin përfundimtar të ofertës, në koston reale të ekzekutimit të kontratës dhe në përgjegjshmërinë e operatorit ekonomik.

Është me rëndësi të theksohet se **vetë Autoriteti Kontraktues,** në fazën e parë të vlerësimit, kishte konstatuar se analiza financiare e GOE Alfa Security SHPK & SIG SHPK nuk ishte në përputhje me Dosjen e Tenderit. Ky

konstatim dëshmon se mangësitë kanë ekzistuar që në momentin e dorëzimit të ofertës.

Megjithatë, në raportin e rivlerësimit dhe në vendimin përfundimtar, Autoriteti Kontraktues ka ndryshuar qëndrimin e tij pa shpjeguar:

- cili element faktik ka ndryshuar;
- cili dokument i ri e ka eliminuar mangësinë;
- mbi cilën dispozitë ligjore është mbështetur ndryshimi i këtij qëndrimi;
- përse analiza financiare tashmë konsiderohet e pranueshme, ndonëse oferta ka mbetur e njëjtë.

Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë **asnjë analizë financiare krahasuese**, nuk ka bërë **asnjë përlogaritje matematikore**, nuk ka analizuar **asnjë nga elementet obligative të kostos** dhe nuk ka shpjeguar se si një analizë financiare që nuk i përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit është konsideruar papritur e rregullt. Ky ndryshim i qëndrimit nuk mbështetet në prova, por vetëm në konkluzione deklarative, gjë që e bën vendimin arbitrar, **të paarsyetuar dhe në kundërshtim me nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik**. Për më tepër, Autoriteti Kontraktues ka toleruar mungesa materiale në analizën financiare të GOE të rekomanduar, ndërkohë që të njëjtin standard nuk e ka zbatuar ndaj operatorëve të tjerë ekonomikë. Kjo përbën njëkohësisht shkelje të **nenit 7 të LPP-së**, pasi krijon trajtim të pabarabartë dhe favorizim të operatorit ekonomik të rekomanduar. Është e qartë se **analiza financiare është pjesë përbërëse e ofertës ekonomike** dhe nuk mund të korrigjohet, plotësohet apo justifikohet përmes procedurës së sqarimit, pasi një veprim i tillë do të përbënte ndryshim të elementeve materiale të ofertës, në kundërshtim me **nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik**. Prandaj, Autoriteti Kontraktues ishte i detyruar ta shpallte ofertën e GOE Alfa Security SHPK & SIG SHPK të papërgjegjshme, pasi ajo nuk i përmbushte kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit dhe të Njoftimit për Kontratë.

Mosveprimi i Autoritetit Kontraktues përbën shkelje të njëkohshme të **nenit 7 (trajtimi i barabartë), nenit 59 (vlerësimi i ofertave sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit) dhe nenit 69 (ndalimi i ndryshimit të elementeve materiale të ofertës)** të Ligjit për Prokurimin Publik.

Për këtë pretendim, Ankuesi i bashkëngjiti si prova materiale:

- Dosjen e Tenderit;
- Njoftimin për Kontratë;
- analizën financiare të GOE Alfa Security SHPK & SIG SHPK;
- raportin fillestar të vlerësimit;
- raportin e rivlerësimit;
- vendimin e Autoritetit Kontraktues;
- kërkesën për sqarim dhe përgjigjet e GOE të rekomanduar;
- si dhe dokumentacionin tjetër përkatës.

Nga këto prova rezulton qartë se analiza financiare e GOE Alfa Security SHPK & SIG SHPK nuk përmbush kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit dhe se Autoriteti Kontraktues, duke e shpallur atë ofertë të përgjegjshme pa asnjë bazë ligjore dhe pa asnjë arsytim të qëndrueshëm, ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik. Për rrjedhojë, vendimi i kontestuar është i paligjshëm dhe duhet të anulohet, ndërsa

procedura duhet të kthehet në rivlerësim në përputhje me dispozitat e LPP-së. Sipas **nenit 6** të Ligjit për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues është i obliguar që fondet publike t'i përdorë në mënyrën **më efikase dhe më ekonomike**, duke marrë parasysh objektin dhe qëllimin e kontratës. Ky parim nuk nënkupton zgjedhjen automatike të ofertës me çmimin më të ulët. Ai nënkupton zgjedhjen e ofertës që është **ligjërish e përgjegjshme**, ekonomikisht e qëndrueshme dhe e aftë të realizojë kontratën në përputhje me të gjitha detyrimet ligjore. Në rastin konkret, GOE i rekomanduar ka paraqitur një analizë financiare që nuk përfshin të gjitha elementet obligative të kostos së kontratës. Për pasojë, çmimi i ofertës nuk pasqyron koston reale të realizimit të kontratës dhe nuk mund të konsiderohet bazë për përdorim efikas të fondeve publike.

Pranimi i një oferte me çmim artificialisht të ulët nuk është zbatim i nenit 6 të LPP-së, por cenim i tij.

Neni 61 i Ligjit për Prokurimin Publik nuk i jep Autoritetit Kontraktues diskrecion që të pranojë automatikisht shpjegimet e operatorit ekonomik kur ekzistojnë dyshime serioze mbi realizueshmërinë e ofertës. Përkundrazi, ky nen e obligon Autoritetin Kontraktues që të zhvillojë një **verifikim real, të plotë dhe objektiv** të strukturës së çmimit dhe të konstatojë, mbi bazën e provave konkrete, nëse oferta mbulon të gjitha kostot e domosdoshme për ekzekutimin e kontratës në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me kërkesat e Dosjes së Tenderit. Në rastin konkret, Ankuesi ka paraqitur pretendime të detajuara dhe të mbështetura në dokumentacionin e procedurës së analiza financiare e GOE të rekomanduar nuk përfshin elemente obligative të kërkuara shprehimisht nga Dosja e Tenderit, përfshirë kontributin pensional në barrë të punëdhënësit, pagesat për punën gjatë ndërrimeve të natës, punën gjatë festave zyrtare, pushimet vjetore dhe elemente të tjera të detyrueshme të kostos së punës. Këto nuk janë mospërputhje formale apo gabime teknike, **por elemente që ndikojnë drejtpërdrejt në çmimin përfundimtar të ofertës dhe në aftësinë reale të operatorit ekonomik për ta realizuar kontratën në përputhje me Ligjin e Punës, kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe obligimet ligjore ndaj punëtorëve.** Pavarësisht këtyre pretendimeve, Autoriteti Kontraktues nuk ka zhvilluar një analizë ekonomike dhe juridike të ofertës së GOE të rekomanduar. Në vendimin e kontestuar nuk paraqitet asnjë përllogaritje, asnjë analizë financiare dhe asnjë arsyetim i bazuar në prova që do të demonstronte se çmimi i ofertës mbulon realisht të gjitha kostot obligative të kërkuara nga Dosja e Tenderit. Autoriteti Kontraktues është mjaftuar me pranimin formal të shpjegimeve të operatorit ekonomik, pa verifikuar nëse ato shpjegime mbështeten nga dokumentacioni financiar dhe pa analizuar nëse, në aspektin ekonomik, oferta është realisht e realizueshme. Një veprim i tillë e zhvesh nga përmbajtja neni 61 të LPP-së, pasi procedura e verifikimit nuk mund të reduktohet në pranimin e deklarimeve të operatorit ekonomik pa një kontroll objektiv të fakteve. Edhe më rëndë, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim se si një analizë financiare që, sipas pretendimeve të Ankuesit, nuk përfshin të gjitha elementet obligative të kostos së punës mund të konsiderohet e mjaftueshme për të garantuar realizimin e kontratës. Mungesa e këtij arsyeimi tregon se nuk është kryer verifikimi substancial që kërkon **neni 61 i LPP-së, por vetëm një shqyrtim formal.** Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar standardin e verifikimit të kërkuar nga neni 61 i Ligjit për Prokurimin Publik, duke pranuar një ofertë pa provuar se ajo është ekonomikisht e realizueshme dhe në përputhje me të gjitha kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit.

XI. VENDOSJA E VLERËS "0" PËR ELEMENTE TË DETYRUESHME TË ANALIZËS FINANCIARE

Një aspekt veçanërisht shqetësues i analizës financiare të operatorit ekonomik të rekomanduar është fakti se për disa nga zërat kryesorë të kostos është vendosur vlera "0".

Në praktikë, kjo nënkupton se operatori ekonomik nuk ka parashikuar asnjë kosto për realizimin e këtyre detyrimeve ligjore. Një analizë financiare e tillë nuk mund të konsiderohet reale. Asnjë kontratë për ofrimin e shërbimeve të sigurimit fizik nuk mund të realizohet pa punë gjatë natës, gjatë vikendeve apo gjatë festave zyrtare, veçanërisht kur vetë objekti i kontratës kërkon sigurim të pandërprerë të objekteve publike. Për rrjedhojë, vendosja e vlerës "0" nuk përfaqëson një metodë të lejuar të kalkulimit, por dëshmon se operatori ekonomik nuk i ka përfshirë fare këto kosto në ofertën e tij. Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë shpjegim juridik se përse një analizë e tillë është konsideruar e pranueshme.

SHKELJA E NENIT 40.16 TË RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK – OFERTA ME VLERË "0.00" PËR NJË ARTIKULL ËSHTË E PAPËRGJEGJSHME DHE DUHET TË REFUZOHET

Një nga shkeljet më flagrante të kryera nga Autoriteti Kontraktues në këtë procedurë është moszbatimi i **nenit 40.16 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 002/2024**, duke pranuar si të përgjegjshme ofertën e **GOE Alfa Security SHPK & SIG SHPK**, ndonëse në analizën financiare dhe në strukturën e kostos janë paraqitur **vlera EUR 0.00** për elemente që përbëjnë pjesë të detyrueshme të kostos së realizimit të kontratës. Kjo nuk është një mangësi formale apo një gabim teknik. Bëhet fjalë për **moslogaritjen e elementeve të detyrueshme të kostos**, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në çmimin përfundimtar të ofertës dhe në mundësinë reale të ekzekutimit të kontratës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në këtë procedurë, vetë **Dosja e Tenderit dhe Njoftimi për Kontratë** kanë kërkuar që analiza financiare të përfshijë në mënyrë obligative:

- pagën bazë prej 500 € bruto;
- kontributin pensional;
- pagesat për punën gjatë natës;
- pagesat për punën gjatë fundjavës;
- pagesat për festat zyrtare;
- pushimet vjetore;
- obligimet e punëdhënësit;
- Fitimin
- TVSH-në;
- totalin e ofertës.

Megjithatë, nga analiza financiare e **GOE Alfa Security SHPK & SIG SHPK** rezulton se për disa nga këta zëra është paraqitur **vlera EUR 0.00**, ndonëse këto nuk janë shërbime fakultative, nuk janë artikuj opsionalë dhe nuk mund të ofrohen pa kosto.

Këto janë **detyrime ligjore**, të cilat burojnë drejtpërdrejt nga **Ligji i Punës**, legjislacioni tatimor dhe dispozitat mbi kontributet pensionale. Për rrjedhojë, ato nuk mund të kenë vlerë **zero**, pasi një kosto e tillë nuk ekziston në realitetin ekonomik dhe juridik të ekzekutimit të kontratës. Pikërisht për të parandaluar praktika të tilla, **neni 40.16 i Rregullores Nr. 001/2022** ka parashikuar një mekanizëm të qartë dhe detyrues.

Dispozita kërkon që, kur një operator ekonomik oferton **EUR 0.00** për një artikull ose element të ofertës, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkojë sqarim. Megjithatë, dispozita nuk përfundon me kërkesën për sqarim. Ajo përcakton edhe **pasojën juridike** të këtij sqarimi. Nëse operatori ekonomik deklaron se elementi nuk është përfshirë në ofertë, **oferta duhet të refuzohet**. Nëse operatori ekonomik deklaron se elementi ofrohet falas, **oferta po ashtu duhet të refuzohet**, pasi procedurat e prokurimit publik nuk lejojnë ofrimin e artikujve apo elementeve të kontratës si dhuratë ose pa kosto. Prandaj, neni 40.16 **nuk i lë Autoritetit Kontraktues asnjë hapësirë diskrecioni** për ta konsideruar një ofertë të tillë si të përgjegjshme. Në rastin konkret, edhe nëse Autoriteti Kontraktues ka zhvilluar procedurën e sqarimit, ai **nuk kishte kompetencë ligjore** që, pas marrjes së përgjigjes së operatorit ekonomik, ta shpallte ofertën të përgjegjshme. Kompetenca e tij përfundonte në momentin kur konstatohej se elementi ishte ofertuar me **EUR 0.00**. Nga ai moment, dispozita e nenit 40.16 impononte refuzimin e ofertës. Autoriteti Kontraktues nuk mund ta anashkalojë një dispozitë detyruese të Rregullores dhe ta zëvendësojë atë me një interpretim subjektiv apo me një arsyetim të përgjithshëm.

Neni 40.6 i Rregullores Nr. 001/2022 përcakton se një tender konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në pajtueshmëri me kërkesat administrative, teknike dhe kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Neni 40.7 sqaron se kjo pajtueshmëri duhet të ekzistojë pa devijime thelbësore, ndërsa **neni 40.8** lejon vetëm sqarimin e ofertës dhe ndalon çdo ndryshim të çmimit ose të ndonjë elementi material të saj. Në procedurën konkrete, Dosja e Tenderit ka përcaktuar kërkesa obligative lidhur me analizën financiare, dokumentacionin teknik dhe administrativ. Megjithatë, nga pretendimet dhe dokumentacioni i referuar në ankesë rezulton se GOE i rekomanduar nuk i ka përmbushur të gjitha këto kërkesa në momentin e dorëzimit të ofertës. Pavarësisht kësaj, Autoriteti Kontraktues e ka konsideruar ofertën si të përgjegjshme dhe, përmes procedurës së sqarimeve, ka pranuar dokumente dhe shpjegime që, sipas Ankuesit, kanë shërbyer për të mbuluar mangësi materiale të ofertës. Një veprim i tillë bie ndesh me **nenin 40.8** të Rregullores, sepse procedura e sqarimeve nuk mund të përdoret për të plotësuar dokumente që mungonin ose për të korrigjuar elemente materiale të ofertës. Sqarimi lejohet vetëm për të shpjeguar dokumentacionin ekzistues dhe jo për ta bërë të përgjegjshme një ofertë që nuk i përmbushte kërkesat obligative në momentin e dorëzimit. Po ashtu, pranimi i një oferte që nuk përmbush kërkesat administrative dhe teknike të Dosjes së Tenderit bie ndesh edhe me **nenet 40.6 dhe 40.7 të Rregullores**, të cilat kërkojnë që një ofertë të jetë plotësisht në pajtueshmëri me Dosjen e Tenderit dhe të mos përmbajë devijime thelbësore që ndikojnë në objektin, cilësinë ose ekzekutimin e kontratës. Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me **Rregulloren Nr. 001/2022** për Prokurimin Publik, duke shpallur të përgjegjshme një ofertë që, sipas pretendimeve të Ankuesit dhe dokumentacionit të procedurës, nuk i përmbushte kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit dhe duke tejkaluar kufijtë e procedurës së sqarimeve.

Veprimi i tij përbën **shkelje të drejtpërdrejta të nenit 40.16**, por njëkohësisht edhe të:

- **nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik**, pasi ka shpallur të përgjegjshme një ofertë që nuk përmbush kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit;
- **nenit 69 të Ligjit për Prokurimin Publik**, pasi ka lejuar që mangësitë materiale të justifikohen ose mbulohen përmes procedurës së sqarimit;
- **nenit 7 të Ligjit për Prokurimin Publik**, pasi operatorëve të tjerë ekonomikë nuk u është dhënë i njëjti trajtim dhe i njëjti tolerim.

Është e papranueshme që elemente të detyrueshme të koston së kontratës të paraqiten me vlerë **EUR 0.00**, ndërsa oferta të konsiderohet megjithatë si ekonomikisht e qëndrueshme dhe juridikisht e përgjegjshme. Një qasje e tillë krijon mundësinë që operatorët ekonomikë të paraqesin oferta artificialisht më të ulëta duke mos përfshirë kosto

reale të kontratës, të fitojnë procedurën dhe vetëm më pas të tentojnë t'i arsyetojnë këto mungesa. Kjo cenon drejtpërdrejt konkurrencën e ndershme, barazinë ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe integritetin e sistemit të prokurimit publik. Për më tepër, vendimi i Autoritetit Kontraktues nuk përmban **asnjë analizë juridike** mbi zbatimin e nenit 40.16 dhe nuk shpjegon përse kjo dispozitë nuk është zbatuar në rastin konkret, ndonëse faktet e procedurës e impononin zbatimin e saj. Mungesa e një arsyetimi të tillë e bën vendimin jo vetëm materialisht të gabuar, por edhe proceduralisht të paligjshëm. Nga këto prova rezulton qartë se GOE Alfa Security SHPK & SIG SHPK ka ofertuar EUR 0.00 për elemente të detyrueshme të kostos së kontratës dhe se, në kundërshtim me nenin 40.16 të Rregullores Nr. 001/2022, Autoriteti Kontraktues nuk e ka refuzuar ofertën, por e ka shpallur atë fituese.

XII. AUTORITETI KONTRAKTUES KA VEPRUAR NË KUNDËRSHTIM ME KËRKESAT E DOSJES SË TENDERIT DHE PARIMIN E LIGJSHMËRISË, DUKE ELIMINUAR OPERATORIN EKONOMIK ANKUES PËR SHKAK TË BUXHETIT, NDËRSA NJËKOHËSISHT KA TOLERUAR MOSRESPEKTIMIN E KËTYRE KËRKESAVE NGA OPERATORI EKONOMIK I REKOMANDUAR

Një nga kundërthëniet më serioze dhe më të dukshme juridike të vendimit të Autoritetit Kontraktues është fakti se ai ka eliminuar **Operatorin Ekonomik Ankues**, me arsyetimin se oferta e tij tejkalon buxhetin e planifikuar, ndërsa njëkohësisht ka shpallur fitues një operator ekonomik, oferta e të cilit **nuk i përmbush kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit dhe të Njoftimit për Kontratë**.

Ky veprim përbën shkelje të njëkohshme të nenit 7, nenit 59 dhe nenit 69 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, si dhe të parimit të ligjshmërisë, trajtimit të barabartë, proporcionalitetit, transparencës dhe vetëdetyrimit të Autoritetit Kontraktues (self-binding principle). Autoriteti Kontraktues pretendon se nuk disponon mjete të mjaftueshme financiare për lidhjen e kontratës me Operatorin Ekonomik Ankues, për shkak se oferta e tij tejkalon buxhetin e planifikuar. Ky arsyetim është juridikisht i paqëndrueshëm. **Planifikimi i buxhetit është përgjegjësi ekskluzive e Autoritetit Kontraktues.** Operatori ekonomik nuk merr pjesë në planifikimin e fondeve publike, nuk ka asnjë ndikim në përlogaritjen e vlerës së parashikuar të kontratës dhe nuk mund të mbahet përgjegjës për një planifikim të gabuar ose të pamjaftueshëm të buxhetit. Për më tepër, **vetë Dosja e Tenderit dhe Njoftimi për Kontratë kanë paraparë shprehimisht se Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën e devijimit të vlerës së kontratës deri në $\pm 30\%$** , sipas kushteve të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit. Kjo do të thotë se vetë Autoriteti Kontraktues ka pranuar dhe ka parashikuar që vlera përfundimtare e kontratës mund të devijojë nga vlera e planifikuar, brenda kufijve të përcaktuar në Dosjen e Tenderit. Prandaj, është juridikisht kontradiktore që, nga njëra anë, të rezervojë këtë të drejtë në dokumentacionin e tenderit dhe, nga ana tjetër, ta përdorë çështjen e buxhetit si arsye eliminimi, pa bërë asnjë analizë nëse oferta e Ankuesit mund të përballohej brenda këtij mekanizmi të devijimit të paraparë nga vetë Autoriteti Kontraktues. Edhe më e rëndë është se vendimi i kontestuar **nuk përmban asnjë analizë financiare, ekonomike apo juridike** mbi pamundësinë e shfrytëzimit të këtij devijimi. Nuk ekziston asnjë përlogaritje, asnjë arsyetim dhe asnjë dispozitë ligjore e cituar nga Autoriteti Kontraktues që të justifikojë moszbatimin e mekanizmit të devijimit prej $\pm 30\%$, ndonëse ai është paraparë nga vetë Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit. Nga ana tjetër, është po Autoriteti Kontraktues ai që ka hartuar Dosjen e Tenderit dhe ka vendosur **kushte obligative**, duke kërkuar që çdo operator ekonomik të përgatisë analizën financiare mbi bazën elementeve kerkuara. Këto nuk kanë qenë rekomandime, por **kushte obligative**, të cilat vetë Autoriteti

Kontraktues i ka konsideruar të domosdoshme për realizimin e kontratës. Pikërisht për këtë arsye, Operatori Ekonomik Ankues ka ndërtuar ofertën e tij duke **respektuar në tërësi Dosjen e Tenderit dhe legjislacionin në fuqi**, duke përllogaritur të gjitha kostot reale të kontratës. Si pasojë, oferta e Ankuesit pasqyron **çmimin real dhe ligjërisht të qëndrueshëm** të realizimit të kontratës. Në anën tjetër, nga dokumentacioni i procedurës rezultoi se **GOE Alfa Security SHPK & SIG SHPK nuk ka përfshirë në analizën financiare të gjitha elementet obligative të kërkuara nga Dosja e Tenderit**, përfshirë kontributin pensional prej 5% në barrë të punëdhënësit, pagesat për punën gjatë natës, festat zyrtare, fundjavat dhe elemente të tjera të kontestuara në këtë Ankesë. Pra, oferta e GOE të rekomanduar është bërë **artificialisht më e ulët**, jo si rezultat i efikasitetit ekonomik apo organizimit më të mirë të punës, por si pasojë e mosllogaritjes së kostove që vetë Autoriteti Kontraktues i kishte shpallur si obligative. Megjithatë, në vend që të zbatojë të njëjtin standard ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në mënyrë diametralisht të kundërt.

Operatori ekonomik që ka respektuar ligjin është eliminuar.

Operatori ekonomik që nuk ka respektuar kërkesat obligative është shpallur fitues.

Një rezultat i tillë nuk është pasojë e konkurrencës së lirë, por e **moszbatimit selektiv të Ligjit për Prokurimin Publik dhe të Dosjes së Tenderit**. Autoriteti Kontraktues nuk mund të vendosë kushte të detyrueshme në Dosjen e Tenderit dhe, pasi operatorët ekonomikë t'i kenë respektuar ato, t'i shpërfillë gjatë fazës së vlerësimit vetëm sepse zbatimi i tyre prodhon një ofertë më të lartë se buxheti i planifikuar. Një veprim i tillë cenon rëndë **parimin e vetëdetyrimit (self-binding principle)**. Ky parim nënkupton se **Autoriteti Kontraktues është i lidhur juridikisht me kriteret dhe kushtet që vetë ka përcaktuar në Dosjen e Tenderit**. Pasi i ka publikuar ato dhe ka ftuar operatorët ekonomikë të ofertojnë mbi atë bazë, ai nuk ka të drejtë t'i ndryshojë, t'i relativizojë, t'i anashkalojë apo të mos i zbatojë gjatë fazës së vlerësimit. Nëse Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se fondet e planifikuara nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar kontratën sipas kushteve që vetë ka vendosur, kjo nuk mund të përdoret si arsye për të penalizuar operatorin ekonomik që ka respektuar ligjin. Përkundrazi, një situatë e tillë tregon një **planifikim të papërshtatshëm të procedurës**, pasojat e të cilit nuk mund të transferohen tek operatorët ekonomikë. Po aq e papranueshme është që Autoriteti Kontraktues të përdorë mungesën e buxhetit si justifikim për të shpallur fitues një operator ekonomik që nuk ka përfshirë të gjitha kostot ligjore të kontratës. Një qasje e tillë krijon një precedent jashtëzakonisht të rrezikshëm, sipas të cilit **fitues nuk shpallet operatori që respekton ligjin dhe Dosjen e Tenderit, por operatori që nuk i përfshin të gjitha kostot reale të kontratës dhe paraqet një ofertë artificialisht më të ulët**. Një praktikë e tillë cenon rëndë konkurrencën e ndershme, favorizon operatorët ekonomikë që nuk respektojnë kërkesat obligative dhe dekurajon operatorët që përgatisin oferta në përputhje me ligjin. Për më tepër, Autoriteti Kontraktues **nuk ka dhënë asnjë analizë financiare, ekonomike apo juridike** që të provojë se oferta e GOE të rekomanduar mund të realizohet në përputhje me Ligjin e Punës dhe me kërkesat e Dosjes së Tenderit, ndonëse vetë dokumentacioni i procedurës dëshmon të kundërtën. Në këto rrethana, është evidente se Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar kriteret që vetë i ka vendosur, ka trajtuar operatorët ekonomikë në mënyrë të pabarabartë dhe ka përdorur çështjen e buxhetit si arsyetim për të eliminuar operatorin ekonomik që ka respektuar plotësisht kërkesat e Dosjes së Tenderit, ndonëse vetë kishte paraparë në dokumentacionin e tenderit mundësinë e devijimit të vlerës së kontratës deri në $\pm 30\%$. Për rrjedhojë, vendimi i kontestuar është **arbitrar, i paarsyetuar, diskriminues dhe në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik**. Për rrjedhojë, arsyetimi i Autoritetit Kontraktues se nuk disponon buxhet të mjaftueshëm nuk përbën bazë ligjore për eliminimin e Operatorit Ekonomik Ankues dhe nuk mund të përdoret për të legjitimuar pranimin e një oferte që nuk është në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe me

dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

XVII. VËNDIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES ËSHTË ABSOLUTISHT I PAARSYETUAR, ARBITRAR DHE NË KUNDËRSHTIM ME LIGJIN PËR PROKURIMIN PUBLIK DHE PARIMET E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

Një nga garancitë më themelore të një procedure të ligjshme të prokurimit publik është detyrimi i Autoritetit Kontraktues që çdo vendim administrativ të jetë i arsyetuar, i bazuar në fakte, prova dhe dispozita konkrete ligjore. Ky detyrim nuk përbën vetëm një kërkesë formale procedurale, por është një element thelbësor i ligjshmërisë së vendimit, i cili garanton transparencën, barazinë e operatorëve ekonomikë dhe mundëson kontrollin efektiv të ligjshmërisë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit. Një vendim administrativ që nuk përmban arsyetim të plotë, nuk analizon provat dhe nuk shpjegon bazën ligjore të përfundimeve të tij, është **arbitrar**, cenon sigurinë juridike dhe nuk mund të prodhojë pasoja juridike. Në rastin konkret, vendimi i Autoritetit Kontraktues **nuk e përmbush as standardin minimal të arsytimit** të kërkuar nga Ligji për Prokurimin Publik dhe nga parimet e përgjithshme të procedurës administrative. Nga analiza e vendimit rezultoi qartë se Autoriteti Kontraktues **nuk ka zhvilluar një shqyrtim real dhe individual të pretendimeve të ngritura në Kërkesën për Rishqyrtim**, por është kufizuar në konstatime të përgjithshme, stereotipe dhe deklarative, pa bërë analizë faktike dhe juridike për secilin pretendim të Ankuesit.

Në Kërkesën për Rishqyrtim janë ngritur pretendime konkrete dhe të argumentuara, të mbështetura me dokumente dhe prova materiale, lidhur me:

analizën financiare të GOE të rekomanduar;

mosllogaritjen e kontributit pensional prej 5% në barrë të punëdhënësit;

mosllogaritjen e pagesave për ndërrimet e natës;

mosllogaritjen e pagesave për punën gjatë fundjavave;

mosllogaritjen e pagesave për festat zyrtare;

mosrespektimin e kërkesave obligative të Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë;

ofertimin e elementeve me vlerë **EUR 0.00**; pranimin e dokumenteve që mungonin përmes procedurës së sqarimeve;

shkeljen e nenit 69 të LPP-së;

shkeljen e nenit 40.16 të Rregullores Nr. 001/2022;

mungesat në dokumentacionin teknik;

mungesat në dokumentacionin administrativ;

trajtimin e pabarabartë të operatorëve ekonomikë;

ndryshimin e qëndrimit të Autoritetit Kontraktues gjatë rivlerësimit pa ndryshuar faktet dhe pa ndryshuar ofertat.

Megjithatë, në vendimin e kontestuar nuk ekziston asnjë analizë individuale për asnjërin nga këto pretendime.

Autoriteti Kontraktues nuk ka shpjeguar: cili pretendim është konsideruar i pabazuar, mbi cilat prova është mbështetur për ta refuzuar secilin pretendim, cilat dokumente i ka analizuar, cilat dispozita të Ligjit për Prokurimin Publik ka zbatuar, përse nuk janë zbatuar dispozitat e Dosjes së Tenderit, përse nuk është zbatuar neni 69 i LPP-së, përse nuk është zbatuar neni 40.16 i Rregullores Nr. 001/2022, përse mungesat materiale të GOE të rekomanduar janë konsideruar të pranueshme, përse analizat dhe provat e paraqitura nga Ankuesi janë injoruar. Në vend të një arsytimi juridik, vendimi përmban vetëm **konkluzione përfundimtare**, pa ndërtuar lidhjen logjike ndërmjet:

fakteve të konstatuara;

provave të administruara;

dispozitave ligjore të zbatueshme;

dhe përfundimeve juridike.

Një vendim i tillë nuk i mundëson Operatorit Ekonomik Ankues të kuptojë arsyet reale të refuzimit të kërkesës së tij, ndërsa njëkohësisht **ia pamundëson edhe Organit Shqyrtues të Prokurimit ushtrimin e kontrollit efektiv mbi ligjshmërinë e veprimeve të Autoritetit Kontraktues**. Mungesa e arsytimit nuk është një mangësi formale. Ajo përbën **shkelje substanciale procedurale**, sepse cenon drejtpërdrejt të drejtën e operatorit ekonomik për një mjet juridik efektiv dhe bie ndesh me parimet themelore të administrimit të mirë, transparencës, objektivitetit dhe sigurisë juridike. Një vendim administrativ nuk mund të mbështetet në supozime, deklaratime të përgjithshme apo konstatime abstrakte. Ai duhet të demonstrojë në mënyrë të qartë **përse faktet e konstatuara çojnë në përfundimin juridik të nxjerrë**. Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë këtë. Për rrjedhojë, vendimi i kontestuar është **absolutisht i paarsyetuar, arbitrar dhe proceduralisht i paligjshëm**, ndaj nuk mund të mbetet në fuqi.

XVIII. PASOJAT JURIDIKE TË SHKELJEVE TË KONSTATUARA

Nga të gjitha faktet dhe provat e administruara në këtë procedurë rezulton se Autoriteti Kontraktues nuk ka zhvilluar një procedurë vlerësimi në përputhje me standardet e përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik.

Shkeljet e konstatuara nuk kanë karakter formal apo teknik, por paraqesin shkelje materiale dhe procedurale që kanë ndikuar drejtpërdrejt në rezultatin përfundimtar të procedurës së prokurimit.

Në jurisprudencën e Organeve Shqyrtuese të Prokurimit është pranuar vazhdimisht se një vendim administrativ nuk mund të mbetet në fuqi kur:

- është nxjerrë mbi bazën e një vlerësimi joobjektiv të ofertave;

- nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm;
- nuk trajton të gjitha pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik;
- zbaton standarde të ndryshme ndaj operatorëve ekonomikë;
- lejon korrigjimin e elementeve materiale të ofertës pas afatit për dorëzimin e tenderëve.

Në rastin konkret janë të pranishme të gjitha këto rrethana.

Autoriteti Kontraktues ka ndryshuar qëndrimin e tij lidhur me të njëjtën ofertë pa shpjeguar bazën juridike të këtij ndryshimi.

Ka pranuar se analiza financiare e operatorit ekonomik të rekomanduar nuk përfshin të gjitha elementet e detyrueshme të kostos, por megjithatë ka arritur në përfundimin se oferta është e përgjegjshme.

Ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim pa analizuar secilin pretendim të ngritur nga Operatori Ekonomik Ankues.

Ka zbatuar standarde të ndryshme të vlerësimit për operatorë ekonomikë të ndryshëm.

Ka lejuar që mangësi materiale të trajtohen sikur të ishin lëshime formale.

Në këto rrethana, vendimi i kontestuar nuk mund të konsiderohet rezultat i një procedure të ligjshme të prokurimit publik.

Andaj duke u bazuar në dëshmitë e paraqitura në këtë Ankersë, kriteret e dosje së tenderit, dhe dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar; faktet e provuara gjatë procedurës së prokurimit; dokumentacionin e administruar në dosjen e tenderit dhe argumentet juridike të paraqitura në këtë ankesë, i propozohet panelit shqyrtues të Organit Shqyrtues të Prokurimit që pas administrimit të provave të nxjerrë VENDIMIN, përmes të cilit:

1. **Ta aprovojë** në tërësi këtë ankesë si të bazuar.
2. **Ta anulojë** Vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin është refuzuar kërkesa për rishqyrtim, pasi i njëjti është nxjerrë me shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale të Ligjit për Prokurimin Publik.
3. **Ta anulojë** Vendimin B54 për rekomandimin për dhënie të kontratës, pasi është rezultat i një vlerësimi të kundërligjshëm të ofertave dhe i zbatimit selektiv të kriterëve të Dosjes së Tenderit.
4. **Ta kthejë** procedurën në rivlerësim, duke obliguar Autoritetin Kontraktues që gjatë rivlerësimit:
 - të bëjë shqyrtim objektiv të të gjitha ofertave;
 - të zbatojë në mënyrë uniforme kriteret e Dosjes së Tenderit;
 - të trajtojë në mënyrë të barabartë të gjithë operatorët ekonomikë;
 - të mos lejojë korrigjimin ose plotësimin e elementeve materiale të ofertës pas hapjes së tenderëve;

- të japë arsyetim të plotë dhe të individualizuar për secilin pretendim dhe për secilin konstatim të vlerësimit.

5. **Të konstatojë** se vendimi i Autoritetit Kontraktues është nxjerrë në kundërshtim me parimet e ligjshmërisë, transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së drejtë, të garantuara nga Ligji për Prokurimin Publik.